



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE TË BQK-së
/për/deri tremujorin e tretë 2025/
-Raport i ndërmjetëm i paaudituar-

Departamenti i Financave

Pasqyrat financiare të BQK-së për tremujorin e tretë 2025

E përcaktuar me Ligjin 03/L-209 “Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (me iniciale BQK), si kornizë raportuese për përgatitjen e pasqyrave financiare janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përkatësisht nenit 58 të Ligjit të lartpërmendur. Këto pasqyra për tremujorin e tretë përfshijnë pasqyrën e gjendjes financiare dhe llogarinë e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe rezerva (ekuitet). Viti financiar i BQK-së përputhet me vitin kalendarik, si rrjedhojë, data e raportit për pasqyrat financiare të tremujorit të tretë 2025 është 30 Shtator 2025.

Shkurtesa të përdorura në raport:

- BQK – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
- FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar
- DST (SDR) – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes
- SNP – Sistemi Ndërbankar i Pagesave
- BQE (ECB) – Banka Qendrore Evropiane
- EUR – Valuta euro
- USD – Dollari Amerikan
- RFI (IFSH) – Instrumenti i Financimit të Shpejtë
- SBA - Marrëveshje aktive për shfrytëzim të linjës kreditore

Pasqyra e gjendjes financiare

sipas të dhënave me:

	Shënim	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Mjetet			
Paraja e gatshme	5	155,593,502.31	77,017,001.78
Llogaritë rrjedhëse	6	118,499,753.74	147,633,101.06
Letrat me vlerë	7	693,113,960.94	732,093,684.07
Plasmanët në tregun e parasë	8	828,847,297.09	506,806,118.27
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	164,844,593.46	180,189,414.06
Prona dhe pajisjet	10	3,876,902.05	4,178,677.11
Mjetet e paprekshme	11	776,069.34	835,644.26
Mjete tjera	12	2,949,275.72	2,673,413.05
Gjithsej mjetet		1,968,501,354.65	1,651,427,053.66
Detyrimet			
Ndaj bankave komerciale në vend	13	662,159,664.22	656,260,393.33
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	177,677,822.04	190,554,491.73
Ndaj institucioneve qeveritare	15	868,707,270.23	575,251,205.59
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	133,657,639.38	104,610,963.52
Nga huamarrja/et	17	1,274,901.82	1,484,213.81
Detyrime tjera vendore	18	2,306,279.07	2,868,882.69
Gjithsej detyrimet		1,845,783,576.76	1,531,030,150.67
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i autorizuar	19	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondet rezervë	20	74,980,114.13	58,780,315.47
Neto rezultati i periudhës		17,737,663.76	31,616,587.52
Gjithsej kapitali dhe rezervat		122,717,777.89	120,396,902.99
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		1,968,501,354.65	1,651,427,053.66

Shpalosjet përkatëse sipas shënimeve prej faqes 6 deri 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare dhe shpalosjet përkatëse të tyre janë aprovuar nga organet vendimmarrëse¹ më datë 23 dhjetor 2025 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:

Nënshkruar nga:
Ahmet Ismaili
Guvernator

Nënshkruar nga:
Faton Ahmetaj
Drejtor,
Departamenti i Financave

¹ Sipas nenit 34 dhe 59 të Ligjit nr. 03/L –209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Pasqyra e përmblodhur e të ardhurave

	Shënim	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024
Të hyrat nga interesi (kamata)			
Të hyrat nga interesi		26,756,625.22	33,705,431.77
Shpenzimet nga interesi		(10,057,146.54)	(13,273,676.30)
Neto të hyrat nga interesi	21	16,699,478.68	20,431,755.47
Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat			
Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat		3,816,651.74	3,452,872.55
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		(1,020,642.43)	(890,900.39)
Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat	22	2,796,009.31	2,561,972.16
Të hyrat nga aktiviteti rregullator dhe të hyra tjera operative			
Të hyrat nga aktiviteti rregullator	23	6,869,981.64	6,154,199.37
Të hyrat nga grantet	24	73,015.27	26,320.93
Të hyrat tjera operative	25	7,385.03	10,148.40
Të ardhurat operative (21+22+23+24+25)		26,445,869.93	29,184,396.33
Shpenzimet administrative			
Shpenzimet për personelin	26	(4,973,481.47)	(3,890,473.88)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(705,649.64)	(651,299.54)
Shpenzime të përgjithshme administrative	27	(1,374,643.29)	(1,083,091.29)
Shpenzimet administrative		(7,053,774.40)	(5,624,864.71)
Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit dhe të provizioneve për humbjet e pritura kreditore		19,392,095.53	23,559,531.62
Neto fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit valutor	28	(1,629,477.05)	(65,518.52)
Provizioni për humbjet e pritura kreditore [(neto rritja)/zvogëlimi]	4	(24,954.72)	(123,213.89)
Neto rezultati i periudhës		17,737,663.76	23,370,799.21

Shënimet prej faqes 6 deri 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (kapital dhe rezerva)

	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Neto rezultati i vitit paraprak (në proces alokimi)	Neto Rezultati (i periudhës)	Gjithsej
Gjendja më 1 Janar 2024	30,000,000.00	39,506,755.59	2,018,432.26	27,631,114.66	-	99,156,302.51
Transferimi në fondin rezervë	-	17,490,638.10	(235,510.48)	(17,255,127.62)	-	-
Transferimi në Thesar (MF)	-	-	-	(10,375,987.04)	-	(10,375,987.04)
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	17,490,638.10	(235,510.48)	(27,631,114.66)	-	(10,375,987.04)
Fitimi për vitin Rregullime gjatë vitit	-	-	-	-	31,616,587.52	31,616,587.52
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	31,616,587.52	31,616,587.52
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	30,000,000.00	56,997,393.69	1,782,921.78	-	31,616,587.52	120,396,902.99
Gjendja më 1 Janar 2025	30,000,000.00	56,997,393.69	1,782,921.78	31,616,587.52	-	120,396,902.99
Transferimi në fondin rezervë	-	15,510,048.13	689,750.53	(16,199,798.66)	-	-
Transferim Thesar (MF)	-	-	-	(15,416,788.86)	-	(15,416,788.86)
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	15,510,048.13	689,750.53	(31,616,587.52)	-	(15,416,788.86)
Fitimi për vitin Rregullime gjatë vitit	-	-	-	-	17,737,663.76	17,737,663.76
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	17,737,663.76	17,737,663.76
Gjendja më 30 Shtator 2025	30,000,000.00	72,507,441.82	2,472,672.31	-	17,737,663.76	122,717,777.89

Shënimet prej faqes 6 deri 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

1. Institucioni Raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, e cila operon sipas Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës të aprovuar në korrik të vitit 2010, si dhe plotësim/ndryshimin më 10 mars 2017 në Ligjin nr. 05/L-150.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Korniza Raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të kostos historike dhe të harmonizuara sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Valuta e funksionale dhe e prezantuar

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në EURO, që është valutë zyrtare funksionale e Kosovës. Në rast se vlerat janë të shprehura në valuta tjera atëherë do të ketë shënim përkatës aty ku janë të paraqitura ato.

3. Politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë të përgatitura duke shfrytëzuar konsistencën e politikave kontabël dhe duhet theksuar se nuk ka pasur ndonjë politikë të re ose ndryshim në politikat e aplikuara kontabël.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Rreziku financiar në BQK është i paraqitur në formën e: rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut kreditor dhe rrezikut të tregut. Pesha më e madhe e rrezikut financiar në BQK, ndërlidhet kryesisht me punët e menaxhimit të mjeteve dhe aktivitetet operative dhe të cilësisë së rregullatorit dhe menaxhohet nga njësitë organizative përkatëse, në përputhje me aktet juridike të aprovuara nga organet vendimmarrëse si Bordi i BQK-së dhe Bordi Ekzekutiv.

Bazuar në kërkesat e standardeve për raportim financiar, sidomos ato që mbulojnë rrezikun kreditor po shpallim elementet se si janë të menaxhuara ekspozimet kreditore dhe të likuiditetit. Portfolio e ekspozimeve është në shtete të Bashkimit Evropian dhe Shtete të Bashkuara të Amerikës me vlerësim kreditor të investueshëm (prej “AAA deri BB-“ dhe/ose “Aaa deri Ba3”) ekspozimi i listuar në tabelën – vlerësimi (Rangimi) kreditor (faqe 7).

Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Vlerat bartëse të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor të ndara sipas llojit dhe të shprehura edhe nga pjesëmarrja në përqindje me gjithsej ekspozimin, janë si më poshtë:

30 Shtator 2025

Vlerësimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë nostro	Plasmanët në tregun e parasë	Letrat me vlerë	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	68,846,183	310,311,822	151,975,860	531,133,865	32.36%
AA+/Aa1/AA+	5,281,138	6,133,037	131,002,240	142,416,414	8.68%
AA/Aa2/AA	203,826	70,222,602		70,426,428	4.29%
AA-/Aa3/AA-	10,603,074	65,014,499	104,360,824	179,978,397	10.97%
A+/A1/A+	13,164,469	206,048,756	39,276,182	258,489,407	15.75%
A/A2/A	17,162,618	65,044,900	15,469,774	97,677,293	5.95%
A-/A3/A-	3,110,467	65,229,858	19,510,087	87,850,412	5.35%
BBB-/Baa3/BBB-	158,970	41,018,319	35,682,373	76,859,662	4.68%
BB-/Ba3/BB-			196,259,598	196,259,598	11.96%
Gjithsej	118,530,746	829,023,792	693,536,939	1,641,091,477	100.00%

31 Dhjetor 2024

Vlerësimi kreditor (S&P/Moody's/Fitch)	Llogaritë nostro	Plasmanët në tregun e parasë	Letrat me vlerë	Gjithsej vlera bartëse	% e peshës me gjithsej
AAA/Aaa/AAA	104,510,067	271,245,909	176,137,628	551,893,604	39.79%
AA+/Aa1/AA+	-	-	137,974,349	137,974,349	9.95%
AA/Aa2/AA	373,883	20,231,497	-	20,605,380	1.49%
AA-/Aa3/AA-	10,169,865	-	163,465,442	173,635,307	12.52%
A+/A1/A+	2,928,395	120,530,011	-	123,458,406	8.90%
A/A2/A	7,220,607	25,043,444	15,505,617	47,769,668	3.44%
A-/A3/A-	21,460,320	50,373,056	29,988,880	101,822,256	7.34%
BBB-/Baa3/BBB-	1,011,775	-	36,700,225	37,712,000	2.72%
BB-/Ba3/BB-	-	19,478,194	172,789,249	192,267,443	13.86%
Gjithsej	147,674,912	506,902,111	732,561,390	1,387,138,413	100.00%

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e ekspozimit në nivel të fazave sipas kërkesave të SNRF 9. Në datën e raportimit nuk kemi ndonjë ndryshim material në rrezik kreditor që nga njohja fillestare e prandaj të gjitha pasuritë financiare janë në fazën 1.

	30 Shtator 2025			31 Dhjetor 2024		
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Faza 1	Faza 2	Faza 3
Llogaritë rrjedhëse me bankat e huaja	118,530,746	-	-	147,674,912	-	-
Letrat me vlerë (Bono thesari dhe obligacione qeveritare)	693,536,939	-	-	732,561,391	-	-
Plasmanët në tregun e parasë	829,023,792	-	-	506,902,110	-	-
Vlera bartëse	1,641,091,477	-	-	1,387,138,413	-	-
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(630,465)	-	-	(605,510)	-	-
Neto vlera bartëse	1,640,461,012	-	-	1,386,532,903	-	-

Lëvizjet e HPK përkatëse për pasuritë financiare që BQK ka ekspozim gjatë periudhës raportuese janë si më poshtë:

	2025			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 Janar 2025	605,510.38	-	-	605,510.38
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK rritja/(zvogëlimi) për vitin	24,954.72	-	-	24,954.72
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç'regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valutor	-	-	-	-
Saldo më 30 Shtator 2025:	630,465.10	-	-	630,465.10

4.Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Lëvizjet e HPK përkatëse për pasuritë financiare që BQK kishte ekspozim gjatë vitit 2024 janë si më poshtë:

	2024			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK me 1 Janar 2024	512,251.10	-	-	512,251.10
Transferet në Fazën 1	-	-	-	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
HPK rritja / (zvogëlimi) për vitin	93,259.28	-	-	93,259.28
Ndikimi në fund të vitit i HPK-ve të ekspozimeve të transferuara midis fazave gjatë vitit	-	-	-	-
Lëshimi i zbritjeve (të njohura në të ardhurat nga interesi)	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në ç' regjistrim	-	-	-	-
Ndryshimet në modelet dhe inputet e përdorura për llogaritjet HPK-së	-	-	-	-
Rregullimet e kursit valutor	-	-	-	-
Saldo me 31 Dhjetor 2024:	605,510.38	-	-	605,510.38

4.Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit (vazhdim)**Vlerat neto bartëse sipas maturitetit të mbetur**

	Shënim	Neto vlera e bartur	Pasuri/asete rrjedhëse			Pasuri/asete afatgjata	
			më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj - 1 vit	1 - 5 vite	mbi 5 vite
30 Shtator 2025							
Mjetet							
Paratë e gatshme	7	155,593,502	155,593,502	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse	8	118,499,754	118,499,754	-	-	-	-
Letra me vlerë	9	693,113,961	19,102,050	9,836,699	160,847,595	496,658,150	6,669,466
Plasmanët në tregun e parasë	10	828,847,297	587,545,968	241,301,329	-	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN (llogaritë)	11	164,064,522	140,563,643	-	-	-	23,500,879
		1,960,119,036	1,021,304,918	251,138,028	160,847,595	496,658,150	30,170,345
Detyrimet							
Ndaj bankave vendore	13	(662,159,664)	(662,159,664)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(176,817,902)	(62,816)	-	-	-	(176,755,086)
Ndaj institucioneve qeveritare	15	(868,707,270)	(868,707,270)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	(133,657,639)	(133,657,639)	-	-	-	-
Nga huamarja / et	17	(1,274,902)	(106,242)	-	(106,242)	(849,934)	(212,484)
Detyrime tjera vendore	18	(761,524)	(761,524)	-	-	-	-
		(1,843,378,902)	(1,665,455,156)	-	(106,242)	(849,934)	(176,967,570)
		116,740,134	(644,150,238)	251,138,028	160,741,353	495,808,216	(146,797,225)
31 Dhjetor 2024							
Mjetet							
Paratë e gatshme	5	77,017,002	77,017,002	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse	6	147,633,101	147,633,101	-	-	-	-
Letra me vlerë	7	732,093,684	-	68,498,355	124,266,053	532,687,558	6,641,718
Plasmanët në tregun e parasë	8	506,806,118	335,317,890	171,488,228	-	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN (llogaritë)	9	179,205,336	153,950,665	-	-	-	25,254,671
		1,642,755,242	713,918,658	239,986,584	124,266,053	532,687,558	31,896,389
Detyrimet							
Ndaj bankave vendore	13	(656,260,393)	(656,260,393)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(189,487,493)	(67,504)	-	-	-	(189,419,990)
Ndaj institucioneve qeveritare	15	(575,251,206)	(575,251,206)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	(104,610,964)	(104,610,964)	-	-	-	-
Nga huamarja / et	17	(1,484,214)	-	(114,170)	(114,170)	(913,363)	(342,511)
Detyrime tjera vendore	18	(759,788)	(759,788)	-	-	-	-
		(1,527,854,057)	(1,336,949,854)	(114,170)	(114,170)	(913,363)	(189,762,501)
		114,901,185	(623,031,196)	239,872,414	124,151,882	531,774,196	(157,866,112)

5. Paraja e gatshme

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Paraja e gatshme	155,593,502.31	77,017,001.78
Gjithsej	155,593,502.31	77,017,001.78

Vërehet një rritje e saldos së parasë së gatshme më 30 Shtator 2025 krahasuar më 31 Dhjetor 2024. Kryesisht e rrjedhur nga operacionet ditore me para të gatshme, por që vlerësohet të jetë brenda kornizave, rrjedhës normale të aktivitetit.

6. Llogaritë rrjedhëse (nostro - me bankat jo rezidente)

Përbërja e llogarive rrjedhëse me banka jo vendore është si më poshtë:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Deutsche Bundesbank	42,320,114.63	47,998,936.99
Raiffeisen Zentralbank	11,563,653.84	1,720,644.05
Banque Centrale du Luxembourg	26,381,583.54	55,761,023.84
Deutsche Bank	4,966,636.00	1,166,217.19
Commerzbank AG	629,412.27	464,815.01
Bank of Lithuania	12,178,478.93	6,026,421.93
DZ Bank AG	203,826.46	373,883.32
Croatian National Bank	3,106,030.95	21,368,345.22
Erste Group Bank AG	971,314.64	742,869.82
National Bank of Belgium	10,315,194.82	10,144,961.97
Banca D'Italia	158,798.19	1,009,297.75
Banque De France	272,728.26	-
Oesterreichische Nationalbank	5,031,756.48	-
Federal Reserve Bank (FED-NY)	242,148.22	326,554.11
	118,341,677.23	147,103,971.20
Interesi i përllogaritur (akruar)	189,068.40	570,941.25
Gjithsej vlera bartëse	118,530,745.63	147,674,912.45
Humbjet e pritura kreditore (HPK)	(30,991.89)	(41,811.39)
Gjithsej vlera neto	118,499,753.74	147,633,101.06

Zëri i llogarive rrjedhëse (nostro), krahasuar më 31 Dhjetor 2024, është zvogëluar kryesisht si derivat i ndryshimeve në rrjedhën e aktivitetit të këtyre llogarive, menaxhimit të portofolit të mjeteve të likuiditetit, si dhe ndikimit të normave të interesit në tregjet financiare. (përkatësisht shënimet 5, 6, 7 dhe 8, që janë shumë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën referuar nga aspekti i menaxhimit të mjeteve/portfolios së instrumenteve financiarë).

7. Letrat me Vlerë (Bonot e thesarit dhe obligacionet)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupit nën shënimin 7 janë letra të borxhit të lëshuara (emetuara) nga vende dhe institucione të ndryshme të Evropës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në analitikë në faqe 12 janë listuar sipas shpërndarjes gjeografike (në tabelën sipas shpërndarjes gjeografike).

7. Letrat me vlerë – vazhdim / sipas shpërndarjes gjeografike dhe llojit:

Bonot e Thesarit të shpalosura po ashtu në faqe 12, kanë maturitet të kontraktuar deri në një vit. Ndërsa, ato të obligacioneve qeveritare kanë maturitet të kontraktuar prej një viti deri në mbi pesë vite. Norma e interesit efektiv në letra me vlerë në periudhën raportuese të vitit 2025 variron në segment nga -0.014% deri 4.929% vjetore (ndërsa, në vitin 2024 variron në segment nga -0.014% deri në 4.997% vjetore).

Letrat me vlerë /sipas shpërndarjes gjeografike (vazhdim):

Shteti	Vlera e bartur 30 Shtator 2025	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera 30 Shtator 2025
Gjermani	38,963,790	(23,722)	38,940,068
Francë	58,667,734	(45,790)	58,621,944
Holandë	73,015,730	(23,206)	72,992,524
Finlandë	58,204,591	(29,263)	58,175,328
Slloveni	19,510,084	(16,210)	19,493,874
Luksemburg	39,996,346	(4,526)	39,991,819
Belgjikë	39,276,182	(25,668)	39,250,514
Austri	60,218,493	(44,508)	60,173,985
Irlandë	45,693,090	(9,124)	45,683,966
Amerikë	12,579,156	(2,012)	12,577,144
Itali	35,682,373	(14,244)	35,668,129
Poloni	15,469,774	(32,201)	15,437,574
Kosovë	196,259,596	(152,505)	196,107,092
Gjithsej	693,536,939	(422,978)	693,113,961

Shteti	Vlera e bartur 31 Dhjetor 2024	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera 31 Dhjetor 2024
Gjermani	58,624,982	(34,176)	58,590,806
Francë	48,499,257	(29,670)	48,469,587
Holandë	73,606,327	(36,550)	73,569,777
Finlandë	67,758,543	(40,032)	67,718,512
Slloveni	29,988,880	(19,025)	29,969,855
Luksemburg	29,542,704	(4,276)	29,538,427
Belgjikë	69,117,474	(36,051)	69,081,423
Austri	70,215,805	(48,556)	70,167,249
Irlandë	45,848,712	(15,171)	45,833,541
Amerikë	14,363,608	(2,130)	14,361,478
Itali	36,700,225	(30,058)	36,670,166
Poloni	15,505,617	(38,307)	15,467,310
Kosovë	172,789,258	(133,705)	172,655,553
Gjithsej	732,561,391	(467,707)	732,093,684

7. Letrat me vlerë (sipas llojit) - vazhdim:

	Vlera e bartur 30 Shtator 2025	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera 30 Shtator 2025
Bono thesari	12,579,156	(2,012)	12,577,144
Obligacione	680,957,783	(420,966)	680,536,817
Gjithsej	693,536,939	(422,978)	693,113,961

	Vlera e bartur 31 Dhjetor 2024	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera 31 Dhjetor 2024
Bono thesari	14,363,608	(2,130)	14,361,478
Obligacione	718,197,783	(465,577)	717,732,206
Gjithsej	732,561,391	(467,707)	732,093,684

8. Plasmanët në tregun e parasë

Në kuadër të këtij grupimi bëjnë pjesë plasmanët në tregun e parasë në bankat tona korrespondente dhe huadhëniet e likuiditetit me bankat e nivelit të dytë e mbështetur me kolateral të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës përmes ekzekutimit të marrëveshjes për riblerjeje. Norma e kamatës për këto plasmane deri në tremujorin e tretë 2025 mesatarisht është rreth 2.273% (minimum: 1.00% dhe maksimum: 4.250%), ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit 2024: në mesatare prej 3.759% (minimum: 3.010% dhe maksimum: 5.30%).

Plasmanët me banka korrespondente kryesisht kanë maturitet të kontraktuar deri në një vit, ndërsa huadhëniet e likuiditeti kanë maturitet deri në dhjetë ditë.

Analitika sipas institucioneve/bankave është e shpalosur në tabelën si më poshtë:

Plasmanët në tregun e parasë sipas bankave:	Vlera e bartur 30 Shtator 2025	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera 30 Shtator 2025
Deutsche Bank	65,000,000	(2,108)	64,997,892
Banque Centrale du Luxembourg	180,000,000	(12,208)	179,987,792
Deutsche Bundesbank	130,000,000	(39,596)	129,960,404
Federal Reserve Bank (NY)	6,132,357	(981)	6,131,375
Banque De France	60,000,000	(23,241)	59,976,759
Banca D'Italia	41,000,000	(16,373)	40,983,627
Croatian National Bank	65,000,000	(32,935)	64,967,065
Raiffeisen Zentralbank	135,983,477	(44,800)	135,938,676
Erste Group Bank AG	70,000,000	(2,585)	69,997,415
DZ Bank AG	70,200,000	(158)	70,199,842
Bank of England	4,957,637	(1,510)	4,956,127
	828,273,470	(176,495)	828,096,975

Plasmanët në tregun e parasë sipas bankave

(Interesi i përllogaritur/akruar):

Deutsche Bank	44,900	-	44,900
Banque Centrale du Luxembourg	248,153	-	248,153
Deutsche Bundesbank	63,669	-	63,669
Federal Reserve Bank (NY)	681	-	681
Banque De France	52,000	-	52,000
Banca D'Italia	18,319	-	18,319
Croatian National Bank	229,844	-	229,844
Raiffeisen Zentralbank	17,465	-	17,465
Erste Group Bank AG	47,822	-	9,567
DZ Bank Ag	22,602	-	47,822
Bank of England	4,865	-	4,865
	750,322	-	750,322
Gjithsej	829,023,792	(176,495)	828,847,297

8. Plasmanët në tregun e parasë - vazhdim

Analitika sipas institucioneve/bankave është e shpalosur në tabelën si më poshtë (vazhdim)

Plasmanët në tregun e parasë sipas bankave:	Vlera e bartur 31 Dhjetor 2024	Humbjet e pritura kreditore	Neto vlera 31 Dhjetor 2024
Deutsche Bank	25,000,000	(1,905)	24,998,095
Banque centrale du Luxembourg	165,000,000	(15,201)	164,984,799
Deutsche Bundesbank	100,000,000	(35,222)	99,964,778
Federal Reserve Bank (NY)	6,064,106	(899)	6,063,207
Banka Kombëtare Tregtare Sh.A.	19,469,000	(8,766)	19,460,234
Croatian National Bank	50,000,000	(26,794)	49,973,206
Raiffeisen Zentralbank	38,406,006	(6,786)	38,399,220
Erste Group Bank AG	82,000,000	(370)	81,999,630
DZ Bank Ag	20,200,000	(50)	20,199,950
	506,139,113	(95,992)	506,043,121
Plasmanët në tregun e parasë sipas bankave (Interesi i përlogaritur/akruar):			
Deutsche Bank	43,444	-	43,444
Banque centrale du Luxembourg	164,757	-	164,757
Deutsche Bundesbank	16,333	-	16,333
Federal Reserve Bank (NY)	716	-	716
Banka Kombëtare Tregtare Sh.A.	9,194	-	9,194
Croatian National Bank	373,056	-	373,056
Raiffeisen Zentralbank	7,830	-	7,830
Erste Group Bank AG	116,171	-	116,171
DZ Bank Ag	31,497	-	31,497
	762,998	-	762,998
Gjithsej	506,902,110	(95,992)	506,806,118

Nëse i krahasojmë periudhën raportuese me periudhën krahasuese trendi shfaqë një rritje të theksuar që kryesisht është rrjedhë normale e menaxhimit të portfolios së instrumenteve financiar si dhe e ndikuar nga mundësia e plasimit, duhet pasur në vëmendje së normat e interesit në valutën euro kanë filluar të shënojnë rënie nëse krahasojmë periudhat e njëjta.

9. Mjetet e ndërlidhura me FMN

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Kuota me/në FMN (pjesa e paguar)	23,500,878.89	25,254,670.98
Depozitat në DST (SDR)	140,563,642.65	153,950,665.49
Kamata akruale	780,071.92	984,077.59
Përdorimi i fondeve të FMN-së (SBA)	-	-
Gjithsej	164,844,593.46	180,189,414.06

Zërat më lart rrjedhin nga anëtarësimi i Kosovës në FMN. Kuota në/me FMN (pjesa e paguar), paraqet vlerën e paguar të kuotës së obligueshme (82,600,000 SDR nga muaji shkurt 2016; ndërsa fillimisht ka qenë 59,000,000 SDR, në vitin 2009) që i është përcaktuar Kosovës nga FMN-ja e shprehur në euro.

Depozitat në DST (SDR) paraqet fillimisht vlerën e depozituar në DST në emër të Republikës së Kosovës sipas vendimeve të Bordit të Guvernatorëve të FMN-së më 28 gusht 2009 (43,737,278 SDR) dhe 9 shtator 2009 (11,631,135 SDR) e ndryshuar për transaksionet – të hyrat dhe shpenzimet e interesit dhe pagesat në emër të rritjes së kuotës po ashtu të shprehura në euro në tabelën më lart.

Si dhe alokimi/shpërndarje e re 2021 (sipas përkufizime të FMN-së) në vlerë prej 79,168,385 DST (SDR) e miratuar nga Bordi i Guvernatorëve të FMN-së më datë 02 gusht 2021 dhe më datë efektive 23 gusht 2021.

Si rrjedhojë zëri i DST-ve në FMN në emër të Republikës së Kosovës është rritur për vlerën në fjalë nga data efektive e transaksionit.

Depozitat në DST – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes (Special Drawing Rights – SDR) dhe pjesërisht pjesa e paguar e kuotës janë depozita që sjellin interes mesatarisht prej 3.02% për periudhën raportuese Janar – Shtator 2025 (ndërsa për Janar – Dhjetor 2024, 3.85%).

Ndërsa, shfrytëzimi i fondeve të FMN-së nga qeveria e Kosovës (këta zëra nuk janë të përfshirë në zëra financiare të BQK-se) në periudhën raportuese 30 Shtator 2025 është 166.6 milion euro (në periudhën krahasuese kjo vlerë ka qenë 80.9 milion euro).

Rritja në rezultat të jetë së gjatë periudhës së tremujorit të dytë qeveria ka tërhequr fonde të reja (rreth 94 milion), po ashtu ka pasur pagesa nga kështet e periudhës.

10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme

Kosto	Investime në objekte	Pajisje	Kompjuter	Automjete	Gjithsej
Më					
01 Janar 2024	6,127,820.60	2,765,248.18	2,282,647.28	389,349.20	11,565,065.26
Blerje	55,388.00	172,920.39	199,926.86	-	428,235.25
Blerje në proces	(3,880.00)	111,297.12	-	-	107,417.12
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	(25,241.97)	(8,222.91)	-	(33,464.88)
Më					
31 Dhjetor 2024	6,179,328.60	3,024,223.72	2,474,351.23	389,349.20	12,067,252.75
Më					
01 Janar 2025	6,179,328.60	3,024,223.72	2,474,351.23	389,349.20	12,067,252.75
Blerje	-	163,463.20	129,449.00	-	292,912.20
Blerje në proces	490.00	(110,097.12)	-	-	(109,607.12)
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	-	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	(7,143.00)	(698.45)	-	(7841.45)
Më					
30 Shtator 2025	6,179,818.60	3,070,446.80	2,603,101.78	389,349.20	12,242,716.38
Zhvlerësimi					
Më					
01 Janar 2024	2,608,166.05	2,441,542.16	1,859,495.27	380,122.53	7,289,326.01
Zhvlerësimi i vitit	310,280.44	114,752.84	170,520.34	9,226.67	604,780.29
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	-	(5,530.66)	-	(5,530.66)
Më					
31 Dhjetor 2024	2,918,446.49	2,556,295.00	2,024,484.95	389,349.20	7,888,575.64
Më					
01 Janar 2025	2,918,446.49	2,556,295.00	2,024,484.95	389,349.20	7,888,575.64
Zhvlerësimi i vitit	237,495.48	103,539.50	136,882.74	-	477,917.72
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	-	(679.03)	-	-
Më					
30 Shtator 2025	3,155,941.97	2,659,834.50	2,160,688.66	389,349.20	8,365,814.33
Neto vlera e bartur					
Më 01 Janar 2024	3,519,654.55	323,706.02	423,152.01	9,226.67	4,275,739.25
Më 31 Dhjetor 2024	3,260,882.11	467,928.72	449,866.28	-	4,178,677.11
Më 30 Shtator 2025	3,023,876.63	410,612.30	442,413.12	-	3,876,902.05

10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme (vazhdim)**Mjetet e paprekshme përbëhen si më poshtë:**

Kosto	Programe/aplikacione kompjuterike	Gjithsej
01 Janar 2024	3,326,210.64	3,326,210.64
Blerje	197,640.26	197,640.26
Blerje në proces	-	-
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
31 Dhjetor 2024	3,523,850.90	3,523,850.90
01 Janar 2025	3,523,850.90	3,523,850.90
Blerje	52,014.00	52,014.00
Blerje në proces	109,000.00	109,000.00
Transfere (nga)/në (korrigjim)	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-
Më 30 Shtator 2025	3,684,864.90	3,684,864.90
Amortizimi		
01 Janar 2024	2,429,891.53	2,429,891.53
Amortizimi për vitin	258,315.11	258,315.11
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	-
Më 31 Dhjetor 2024	2,688,206.64	2,688,206.64
Më 01 janar 2025	2,688,206.64	2,688,206.64
Amortizimi për vitin	220,588.92	220,588.92
Nxjerrje jashtë përdorimit (shlyerje)	-	-
Më 30 Shtator 2025	2,908,795.56	2,908,795.56
Neto vlera e bartur		
Më 01 Janar 2024	896,319.11	896,319.11
Më 31 Dhjetor 2024	835,644.26	835,644.26
Më 30 Shtator 2025	776,069.34	776,069.34

12. Mjetet tjera

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Llogarit e arkëtueshme	2,368,071.32	2,545,919.12
Parapagime për shërbime	517,797.69	131,107.71
Parapagime për personel	63,406.71	-
Pagesa/Kërkesa në proces (SNP/DepoX)	-	(3,613.78)
Gjithsej	2,949,275.72	2,673,413.05

Kërkesat në proces (ATS) do të shlyhen pasi sistemi të ekzekuton pagesat në ditën e dytë të ardhshme të punës.

13. Detyrimet ndaj bankave (qe veprojnë në Kosovë)

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
ProCredit Bank Kosovë	92,140,326.76	94,384,329.16
Raiffeisen Bank Kosovë	100,585,460.90	79,091,969.58
NLB Prishtina	164,182,152.74	140,918,202.72
Banka Ekonomike	46,871,659.34	60,264,951.35
Banka për Biznes	46,928,684.70	36,310,742.96
Banka Kombëtare Tregtare Sh.A	83,700,398.72	116,703,570.29
Turk Ekonomi Bankasi Sh.A.	82,428,890.52	87,083,188.08
Turkiye Is Bankasi A.S.	5,388,813.76	7,085,600.13
T.C. Zirat Bankasi A.S.Dega Kosovë	18,664,571.50	14,895,921.94
Banka Kreditore e Prishtinës	113,644.77	135,653.18
Banka Credins Kosovë	5,498,985.05	4,139,221.89
PriBank Sh.A.	15,516,042.84	15,114,113.18
Gjithsej (pa interes akrual)	662,019,631.60	656,127,464.33
Interesi akrual	140,032.62	132,928.97
Gjithsej	662,159,664.22	656,260,393

Të shpalosura në këtë grup janë saldot e bankave të nivelit të dytë që operojnë në vend (Kosovë). Dhe të cilat në BQK mbajnë mjetet sipas rregullativës ligjore për rezervën e likuiditetit.

Në total shuma e shpalosur më lart për periudhën raportuese 30 Shtator 2025 është rreth 2.07 herë më e lartë se sa vlera e rezervës së obliguar që kërkohet të mbahet në BQK (ndërsa ky raport më 31 dhjetor 2024 po ashtu 2.3 herë).

Nga 1 Janari 2025, BQK-ja aplikon normë pozitive 0.30% (vjetore), ndërsa norma 0.30% ka qene edhe gjatë vitin 2024 për të gjithë depozituesit e BQK-së.

Të njëjtën normë e aplikon në saldot e bankave komerciale në BQK deri në nivelin rezervën minimale të detyrueshme. Për bankat që kanë saldo mbi nivelin e rezervës minimale të detyrueshme, interesi do të aplikohen deri në vlerën e rezervës minimale të detyrueshme në nivel të bankës.

14. Detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Llogaria shpenzimeve FMN Nr. 2	62,815.85	67,503.59
Pjesa e paguar e Kuotës te FMN-ja (nga qeveria)	19,659,155.37	20,600,514.22
Alokime nga FMN-ja në formë të DST	157,095,930.75	168,819,475.31
Kamata akruale	859,920.07	1,066,998.61
Gjithsej	177,677,822.04	190,554,491.73

Zërat më lart paraqesin pozicionet e llogarive të ndërlidhura me FMN-në që kanë rrjedhur pas anëtarësimit të Kosovës në FMN. Llogari nr.2 me FMN është llogari operative.

Pjesa e paguar e kuotës (paguar nga qeveria e Kosovës), si dhe ka të përfshirë edhe interesin e paguar nga IMF për këtë zë, sipas rregullativës së FMN-së, e cila në tabelë nën shënimin 14 është e shprehur në euro.

Alokimet në formë të Drejtave Speciale të Tërheqjes (DST/SDR) në FMN, përbëhen nga alokimet e përmendura në shënimin 9 më 28 Gusht dhe 9 Shtator 2009, si dhe shpërndarja (emetimi/alokimi) në vitin 2021.

Norma e interesit për zërin e alokimeve për periudhën raportuese dhe krahasuese është e njëjtë sikurse tek depozitat DST (SDR).

Në vitin 2023 FMN ka aprovuar dy lloje të reja të financimit në emër të Kosovës, një Linje kreditore dhe Instrumentin për qëndrueshmëri dhe stabilitet (buxhetor) dhe në vitin 2020 ka qenë i aprovuar instrumenti për financim të shpejt.

Saldo e tërhequr e mjeteve nga këta instrumentet financiar me 30 Shtator 2025 është 166.6 milion euro, ndërsa me 31 Dhjetor 2024 ka qenë 80.9 milion euro, ndryshimi rrjedh nga pagesat e kësteve dhe lëvizja/ndryshimet e kursit të këmbimit EUR/SDR). Saldot e rrjedha nga këto tërheqje të fondeve nuk janë të përfshira në kuadër të zërave financiarë të BQK-së.

15. Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare kanë këtë përbërje:

Llogarit rrjedhëse	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Thesari – Ministria e Financave	376,807,014.98	249,422,246.74
Agjencia Kosovare për Privatizim	191,144,219.50	179,142,870.08
Institucionet e Përkohshme Administrative	159,792.91	66,037.83
Gjithsej llogarit rrjedhëse	568,111,027.39	428,631,154.65
Interesi akrual në llogari rrjedhëse		
Thesari – Ministria e Financave	96,703.93	73,659.73
Agjencia Kosovare për Privatizim	47,532.25	45,679.18
Institucionet e Përkohshme Administrative	39.99	17.59
Gjithsej interesi akrual	144,276.17	119,356.50
Depozitat afatshkurtra		
Thesari – Ministria e Financave	300,451,966.67	146,500,694.44
Agjencia Kosovare për Privatizim	-	-
Institucionet e Përkohshme Administrative	-	-
Gjithsej depozitat afatshkurtra	300,451,966.67	146,500,694.44
Gjithsej	868,707,270.23	575,251,205.59

Depozitat në llogari rrjedhëse nga përfitojnë interes prej 0.30%, ndërsa nga 1 janar 2024 po ashtu kanë përfituar interes prej 0.30%.

Afatizime aktive në periudhën raportuese ka vetëm nga llogaritë e qeverisë (vlera e shpalosur në tabelë). Ndryshimi është rrjedhë e aktivitetit operativ të institucioneve që përbëjnë grupin.

16. Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale

Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale të paraqitura në vijim:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Kompanitë e sigurimeve	4,173,005.32	4,163,683.54
Institucione dhe kompani publike	98,143,223.58	89,482,546.35
Trusti i kursimeve pensionale (TKPK)	31,307,903.52	10,927,416.69
Fondet e pensioneve jopublike dhe tjera	1,813.07	1,814.80
Gjithsej llogarit rrjedhëse	133,625,945.49	104,575,461.38
Interesi akrual në llogari rrjedhëse		
Kompanitë e sigurimeve	1,043.29	1,075.68
Institucione dhe kompani publike	24,531.82	25,016.32
Trusti i kursimeve pensionale (TKPK)	6,118.31	9,409.65
Fondet e pensioneve jopublike dhe tjera	0.47	0.49
Gjithsej interesi akrual	31,693.89	35,502.14
Gjithsej	133,657,639.38	104,610,963.52

Institucionet dhe kompani publike përbëhen prej llogarive nga Fondi i Sigurimeve të Depozitave, Fondi për Garanci kreditore dhe llogaritë në mirëbesim të KEK (Korporatës Energjetike të Kosovës), si përbërës më me peshë. Depozitat në llogari rrjedhëse përfitojnë interes prej 0.30%, ndërsa nga 1 janar 2024 po ashtu kanë përfituar interes prej 0.30%.

17. Detyrimet nga Huamarrja/et

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Huamarrje nga Banka Botërore	1,274,901.82	1,484,213.81
Gjithsej	1,274,901.82	1,484,213.81

Kemi dy projekte që janë financuar nga Banka Botërore përmes kredisë: projekti për *Planin e vazhdimësisë së punës* dhe projekti për *Sistemin e pagesave në kohë reale (RTGS)*. Projekte këto të implementuara në vitin 2016. Kthimi i mjeteve është me afat mbi 10 vjet. Ndryshimi rrjedhë si rezultat i pagesave të kryegjësë dhe konvertimit të vlerës aktive nga DST (SDR) në EUR në datë e raportimit.

18. Detyrime tjera

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Llogari në përkujdesje	761,714.75	759,984.01
Të hyrat e shtyra	50,289.03	77,188.86
Llogari të pagueshme dhe shpenzime akruale	821,950.28	1,359,384.81
Përfitimet afatgjata për punonjësit	672,325.01	672,325.01
Gjithsej llogarit rrjedhëse	2,306,279.07	2,868,882.69

Në kuadër të grupit vërehet zvogëlim në gjithsej saldon e grupit krahasuar më 31 dhjetor 2024. Kryesisht i ndikuar nga zvogëlimi i saldosh të llogarive të pagueshme dhe të hyrave të shtyra më 30 Shtator 2025, krahas asaj më 31 Dhjetor 2024. Zvogëlimi është kryesisht rrjedhë e saldove në datën e raportimit dhe ekuilibrohet pas datës së raportimit (një transaksioni në proces dhe i cili shlyhet në datën vijuese të punës).

19, 20 Kapitali i autorizuar dhe Rezervat**Kapitali dhe Rezervat e Përgjithshme**

	30 Shtator 2024	31 Dhjetor 2024
Kapitali i autorizuar	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondet rezervë	74,980,114.13	58,780,315.47
Rezultati neto i periudhës	17,737,663.76	31,616,587.52
Gjithsej	122,717,777.89	120,396,902.99

Rezultati financiar i periudhës është pozitiv për rreth 17.7 milionë euro, i ndikuar kryesisht nga realizimi i kënaqshëm i të hyrave dhe mbajtja e shpenzimeve sipas planifikimit financiar për periudhën raportuese.

Zëri i rivlerësimit valutator në datën e raportimit është në vlerë prej rreth 1,629 mijë euro (si humbje e përcaktuar), zëri i provizioneve për humbjet e pritura kreditore [(neto rritja)/zvogëlimi] është në vlerë rreth 25 mijë euro (si humbje e provizioneve) dhe nëse i përjashtojmë këta dy zëra rezultati financiar mbetet pozitiv prej rreth 19.4 milionë euro (shiko faqe 6 - *Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit dhe të provizioneve*).

19, 20 Kapitali i autorizuar dhe Rezervat (vazhdim)

Sipas nenit 56, paragrafi 1.1. të ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ardhurat neto së pari do të shpërndahen në rezervën të përgjithshme derisa shuma totale e kapitalit fillestar dhe rezervat e përgjithshme barazohen me pesë për qind (5%) të detyrimeve monetare të Bankës Qendrore. Pjesa prej 50% e bilancit neto të të ardhurave të realizuara që mbeten pas përmbushjes së kriterit të 5% të përmendur më lart, duhet t'i transferohet Ministrisë së Financave. Ndërsa 50% që mbetet nga të ardhurat e realizuar duhet t'i alokohet llogarisë së rezervës së përgjithshme të BQK-së.

Të ardhurat e ndashme		
Përshkrimi	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	17,737,663.76	31,616,587.52
Nga të cilat janë fitimet (fitimet) e perealizuara nga rivlerësimi	-	783,009.81
Nga të cilat janë humbjet e perealizuara të rivlerësimit të cilat janë realizuar në vitin aktual	-	-
Të ardhurat e ndashme	17,737,663.76	30,833,577.71
Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme		
	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Kapitali	30,000,000.00	30,000,000.00
Rezervat e përgjithshme	72,507,441.82	56,997,393.69
Të ardhurat e ndashme	17,737,663.76	30,833,577.71
Gjithsej Kapitali, llogaria e rezervës së përgjithshme dhe të ardhurat e ndashme	120,245,105.58	117,830,971.40
Gjithsej detyrimet monetare		
	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Ndaj bankave komerciale vendore	662,019,632	656,127,464
Ndaj institucioneve qeveritare	868,111,027	574,631,155
Ndaj llogarive të lidhura me FMN ²	176,817,902	189,487,493
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	133,625,945	104,575,461
Nga huamarrja/et	1,274,902	1,484,214
Ndaj detyrimeve tjera monetare	761,524	759,788
Gjithsej detyrimet monetare	1,842,610,933	1,527,065,575
Raporti sipas nenit 56, paragrafi 1.1.	6.53%	7.72%

² Përfshijë llogarinë e letrave me vlerë dhe akrualet.

21. Të hyrat neto nga interesi

	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024
Të hyrat nga interesi		
Prej depozitave në llogarinë rrjedhëse	2,689,025.24	10,051,665.91
Prej afatizimeve në plasmanë	10,060,064.30	10,169,149.18
Prej letrave me vlerë	10,729,758.32	8,903,865.61
Prej depozitave me llogaritë me FMN (DST/SDR në posedim)	3,277,777.36	4,580,751.07
	26,756,625.22	33,705,431.77
Shpenzimet e interesit		
Ndaj bankave rezidente në llogarinë rrjedhëse	1,224,988.14	1,069,935.28
Ndaj institucioneve qeveritare në llogarinë rrjedhëse	1,039,152.43	1,172,781.03
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale në llogarinë rrjedhëse	322,187.49	308,262.04
Tjera në llogarinë rrjedhëse	1,730.74	1,731.77
Ndaj Thesarit-Ministria e Financave në depozita afatshkurtra	3,835,750.03	5,753,750.89
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN (DST/SDR të alokuar)	3,625,684.76	4,958,009.31
Nga huazimi/et	7,652.95	9,205.98
	10,057,146.54	13,273,676.30
Të hyrat neto nga interesi	16,699,478.68	20,431,755.47

Ashtu si edhe vërehet nga tabela nën shënimin 21, të hyrat nga interesi janë realizuar më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar si dhe shpenzimet pak më të larta. Kjo ka ndikuar që neto të hyrat nga interesi janë më të ulëta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Norma mesatare e interesit për neto të hyrat nga interesi (duke marrë në konsideratë vetëm portfolion e angazhuar) për periudhën raportuese është rreth 1.391 (në periudhën e njëjtë të vitit 2024 ka qenë rreth 1.927%).

22. Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat në shërbime

	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024
Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat		
Nga depozitat/tërheqjet në para të gatshme	1,270,257.00	1,153,580.50
Nga transferet hyrëse	87,090.00	85,902.00
Nga transferet dalëse	544,321.72	471,190.00
Nga transferet vendore (Sistemi i pagesave vendore)	1,688,268.52	1,550,421.85
Nga sistemi i regjistrimit të kredive	210,361.50	177,720.20
Të hyra nga tarifa tjera	16,353.00	14,058.00
	3,816,651.74	3,452,872.55
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		
Prej qarkullimit të parasë së gatshme	978,024.29	852,765.18
Nga transaksionet me banka korrespondente	42,618.14	38,135.21
	1,020,642.43	890,900.39
Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat	2,796,009.31	2,561,972.16

22. Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat në shërbime (vazhdim)

Vërehet një rritje e lehtë në neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, kjo është nga rrjedha normale e aktivitetit për zërat e shpalosur në kuadër të grupit (ndryshim në volum veçanërisht të *aktiviteti i qarkullimit të parasë se gatshme, transferet dalëse (ndërkombëtare) si dhe transferet vendore*).

23. Të hyrat nga aktiviteti rregullator

	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024
Nga mirëmbajtja e licencave të bankave	4,604,393.13	3,996,523.79
Nga licencat prej institucioneve bankare	36,700.00	61,300.00
Nga mirëmbajtja e licencave të kompanive të sigurimeve	1,852,021.85	1,755,246.75
Nga licencat prej kompanive të sigurimeve	58,500.00	73,500.00
Të hyrat nga aktiviteti rregullator i fondeve pensionale	22,523.17	20,722.64
Nga aktiviteti rregullator i institucioneve tjera financiare (jobankare)	295,843.49	246,906.19
Gjithsej	6,869,981.64	6,154,199.37

Ndryshimi si rritje kryesisht është i mbështetur në vlerësime (akrualet e vlerësuara) e rritjes së bazës (bazës përlllogaritëse/volumit të aktivitetit) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

24. Të hyrat nga grantet

	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024
Të hyrat nga grantet	73,015.27	26,320.93

Granti për *sistemin e mbikëqyrjes financiare*, është granti i vetëm aktive (në të hyra) për periudhën Janar-Shtator 2025. Ndërsa, ka dhe presim rimburesime edhe nga Granti me BQE (ECB) për trajnimet e realizuara përmes atij projekti.

25. Të hyrat tjera operative

	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024
Të hyra tjera	7,385.03	10,148.40

Ky grup përbëhet nga të hyra prej aktiviteteve jo të zakonshme të BQK-së dhe të cilat nuk kanë mundur të klasifikohen në zërat specifikë të të hyrave. P.sh. shitja e tokenëve që përmbajnë certifikata për qasje në sistem Depo-x, për klientët shfrytëzues të sistemit në fjalë, kryesisht ndaj bankave komerciale dhe të ngjashme.

26. Shpenzimet e personelit

	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024
Shpenzimet e pagave dhe kompensimeve	3,643,903.87	2,843,576.04
Shpenzimet e kontributeve dhe sigurimi shëndetësor	877,542.18	704,381.23
Shpenzimet e trajnimeve	101,669.82	53,956.93
Shpenzimet për Bordin e BQK-së	132,831.17	101,716.90
Shujta ditore	187,320.00	168,382.50
Shpenzime tjera	30,214.43	18,460.28
Gjithsej	4,973,481.47	3,890,473.88

Gjithsej numri i të punësuarve që kanë qenë aktivë në listën e pagave gjatë periudhës janar – shtator 2025 është: 247 (në periudhën janar - shtator 2024, 230).

Në kategorinë *tjera të shpenzimet e personelit* përfshihet *kompensimi shtesë pensional, mbështetja financiare për strehim dhe programi i praktikës së studentëve*.

Kompensimi shtesë pensional është rrjedhojë e vendimeve të mëhershme, nga ku disa ish punëtorë kompensohen drejtpërdrejt nga BQK-ja, në pamundësi për bartjen e këtij detyrimi ndaj tyre te fondet pensionale në momentin kur BQK-ja ka bartur menaxhimin e fondit shtesë pensional.

27. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024
Shpenzimet e sigurimit	233,367.12	202,827.74
Shpenzimet e operative për para të gatshme	40,495.00	27,787.55
Riparime dhe mirëmbajtje	72,658.29	61,980.70
Mirëmbajtje te aplikacioneve	377,565.39	313,757.07
Shpenzime komunikimi (telefoni, fax-i dhe interneti)	35,530.97	24,720.81
Shpenzimet e shërbimeve publike	60,020.47	64,715.68
Shpenzimet e konsultimeve dhe te auditimit	79,021.91	12,462.71
Shpenzime te sigurimit fizik (te objektit)	122,119.20	124,417.10
Udhëtimet dhe transporti	138,783.00	92,099.16
Shpenzimet operative te automjeteve	15,718.91	13,762.88
Material shpenzues administrativ	4,469.21	3,474.50
Shpenzimet e kafitërisë	40,174.80	35,379.52
Shpenzimet e konferencave (organizimet)	10,646.54	2,600.00
Shpenzimet e edukimit financiar	4,399.30	569.00
Shpenzime për furnizime (për pajisje te TI dhe jo TI)	8,594.33	6,615.55
Publikimet dhe literatura dhe tjera	8,985.90	16,068.89
Shpenzime e përfaqësimit	34,017.17	29,798.89
Tarifa anëtarësimi ne institucione profesionale	51,388.27	42,092.54
Tjera	36,687.51	7,961.00
Gjithsej	1,374,643.29	1,083,091.29

27. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative (vazhdim)

Ndryshimet të shpenzimet e përgjithshme administrative janë rrjedhë e aktiviteteve dhe vendimeve operative, si dhe pjesërisht nga ndonjë aktivitet që nuk ka pasur periodicitet të njëjtë në periudhat krahasuese. Duhet theksuar se anëtarësimet në institucione profesionale janë me trend rritës pasi edhe ashtu kemi zgjeruar institucione ku janë bërë anëtarësime përkatëse.

28. Neto rezultati nga ndryshimet e kursit të këmbimit

	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024
Rivlerësimi valutor		
nga zëri në USD	(2,504,717.15)	(141,027.24)
nga zërat në SDR	911,926.91	75,508.72
nga zërat GBP	(36,686.81)	-
Neto fitimi/(humbja) e perealizuar (nga ndryshimi i kursit të këmbimit)	(1,629,477.05)	(65,518.52)

Rezultati i paraqitur më lart është i përkohshëm (specifikisht vetëm për datën e raportimit) dhe mund të lëvizë varësisht nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR dhe EUR/USD.

29. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Shënim	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Paraja e gatshme	155,593,502.31	77,017,001.78
Llogaritë rrjedhëse me bankat jo rezidente	118,341,677.23	147,103,971.20
Letra me vlerë me maturitet deri në tre muaj	-	9,582,878.63
Plasmanët në tregun e parasë dhe me maturitet deri në tre muaj	577,768,523.65	305,139,112.62
Gjithsej	851,703,703.19	538,842,964.23

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen për qëllim të përmbushjes së detyrimeve të likuiditetit kryesisht afatshkurtër. Një investim kualifikohet si ekuivalent i parasë kur ai ka maturitet afatshkurtër, më pak se tre muaj nga data e blerjes.

30. Detyrimet e pritura dhe kontingjente**Anëtarësimi në Bankën Botërore**

Pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe nënagjencionet e saj, Qeveria e Kosovës ka lëshuar nota të pagueshme (sipas kërkesës) duke u zotuar se do të paguajë sipas kërkesës së Bankës Botërore (nënagjencioneve të saj) për pjesën e tarifës së anëtarësisë. Vlera e tyre më 30 Shtator 2025 është rreth 717,783.³⁰ euro (më 31 dhjetor 2024 ky detyrim i pritshëm ka qenë 718,687.⁵⁴ euro), BQK luan rolin e ndërmjetësit financiar (bankës garantuese) dhe mjetet mbahen në llogari nën përkujdesje (garantuese).